



BULETINI

Botimi Nr.

06

MUJOR **KORRIK** 2026



Grant 2026 për Inovacionin:

U shpallën startup-et dhe inkubatorët fitues të mbështetur përmes Grant 2026, me një fond të dyfishuar prej 6 milionë eurosh, i cili është investimi më i madh publik dedikuar zhvillimit të ekosistemit inovativ në vend.



01 KORRIK

Takim me Ekspertë Gjermanë:

Në Qendrën për Hapje e Dialog një grup ekspertësh nga Ministria Federale Gjermane e Ekonomisë dhe Energjisë, ku u prezantua rrugëtimi i Shqipërisë drejt ekonomisë së tregut dhe integritit evropian.

02 KORRIK

Vizitë Zyrtare në Gjermani:

Gjatë vizitës në Düsseldorf u diskutua me Kryeministrin e Landit të Nordrhein-Ëestfalen mbi bashkëpunimin ekonomik dhe inovacionin, si dhe u prezantua vizioni i Shqipërisë për inteligjencën artificiale në forumin Ruhr Summit.



Marrëveshja për Punësimin me Kosovën:

U nënshkrua në Tiranë, Marrëveshja për Mobilitetin në Punë mes Shqipërisë dhe Kosovës, e cila lehtëson lëvizjen e fuqisë punëtore dhe përmirëson shërbimet për qytetarët e të dy vendeve.



03 KORRIK

Raporti i OECD për NVM-të:

Në prezantimin e raportit OECD SME Policy Index 2026, u theksua progresi i dukshëm i Shqipërisë në përmirësimin e mjedisit të biznesit, digjitalizimin e shërbimeve dhe mbështetjen e sipërmarrjes.



03 KORRIK

Bashkëpunimi me Francën:

U diskutua me Ambasadoren e Francës mbi thellimin e bashkëpunimit për zhvillimin e aftësive profesionale, me fokus te projekti i binjakëzimit mes shkollave të hotelerisë dhe turizmit të Korçës me ato franceze.

Transformimi i biznesit

Standardizim

Tranzicion i
gjelbër

Transformim
digjital

Inovacion

Certifikim

Zhvillim i
aftësive

SHQIPËRI
TREGUT
EURO

06 KORRIK

Përgatitja e Biznesit për BE:

U prezantua Programi Kombëtar për Përgatitjen e Biznesit për Integrimin në Tregun Unik European, i cili synon mbështetjen e sipërmarrjeve shqiptare përmes informimit, certifikimit dhe transformimit digjital.



07 KORRIK

Forumi i Diasporës në Berlin:

Gjatë BNA Berlin 2026, u theksua roli strategjik i diasporës shqiptare në zhvillimin ekonomik, si dhe rëndësia e platformave që nxisin rrjetëzimin dhe investimet në Shqipëri.



08 KORRIK

Tryeza për Tregun Unik European:

Në një diskutim me komunitetin e biznesit u prezantuan detajet e programit që synon të përgatisë dhe mbështesë rreth 48 mijë ndërmarrje shqiptare për përmbushjen e standardeve evropiane.

**08 KORRIK**

Zbatimi i Garancisë Rinore:

Në mbledhjen e Grupit Teknik të Punës u vlerësua progresi i programit evropian Garancia Rinore, i cili ka ulur ndjeshëm papunësinë e të rinjve NEET dhe që po shtrihet në mbarë vendin për periudhën 2026-2028.

**10 KORRIK**

Statuti i Shoqërisë Evropiane:

Projektligji i ri u jep kompanive shqiptare mundësinë të organizohen sipas standardeve të BE-së, duke synuar një kornizë moderne që rrit besimin e investitorëve dhe konkurrueshmërinë.

I RI
ËR

11
SHTYLLA
PROGRAM

10 KORRIK

Programi Rilindja 2.0:

U prezantua rëndësia e këtij programi të ri që vendos në fokus ekonominë, sipërmarrjen dhe inovacionin, duke u dhënë mundësi bashkive të zhvillojnë identitetin e tyre ekonomik dhe të tërheqin investime.



14 KORRIK

Përparim në Negociatat me BE:

Në Konferencën e IX Ndërqeveritare në Bruksel u formalizua mbyllja e Kapitujve 25, 26 dhe 30, duke shënuar një arritje të rëndësishme për integrimin, kërkimin shkencor, arsimin dhe politikën tregtare.

**15 KORRIK**

Sigurimet Shoqërore me Slloveninë:

Këshilli i Ministrave miratoi në parim marrëveshjen dypalëshe që garanton trajtimin e barabartë, njohjen e kontributeve dhe mbrojtjen sociale për qytetarët që punojnë në Shqipëri dhe Slloveni.

**16 KORRIK**

Tregu i Lirë i Shërbimeve:

U theksuan përfitimet e Kapitullit 3 të negociatave me BE-në, i cili do të lejojë profesionistët shqiptarë të ofrojnë shërbime në gjithë tregun evropian me procedura të thjeshtuara dhe njohje kualifikimesh.



17 KORRIK

Programi “Dyfisho Sipërmarrjen Tënde”:

Nisi zyrtarisht iniciativa kombëtare për mbështetjen e bizneseve, e cila ofron financim me kushte të favorshme dhe garanci sovrane për të nxitur investimet në sektorë kyç si turizmi, bujqësia dhe inovacioni.



20 KORRIK

Mbledhja e Këshillit të Investimeve:

Nën drejtimin e Ministrisë së Ekonomisë u konsultuan me përfaqësuesit e biznesit draftet e Strategjisë së Industrisë dhe Politikës për NVM-të 2026-2030, me fokus rritjen e konkurrueshmërisë.



22 KORRIK

Përgatitjet për Rrjetin EURES:

U mbajt një takim ndërinstitutional për përmbushjen e kriterëve të Kapitullit 2, me fokus përafrimin me Autoritetin Evropian të Punës dhe integrimin teknik të tregut shqiptar të punës në portalin EURES.



23 KORRIK

Vizitë te Bizneset Vendase:

Gjatë vizitës te kompania “Europtik”, u theksua mbështetja që ofron Programi “Dyfisho Sipërmarrjen Tënde” si një mjet për financimin dhe zgjerimin e sipërmarrjeve të suksesshme shqiptare.



23 KORRIK

“Dyfisho Sipërmarrjen Tënde” Vizitë në IPACK:

Gjatë vizitës në kompaninë IPACK, u prezantuan mundësitë e programit “Dyfisho Sipërmarrjen Tënde” për investime në teknologji, inovacion dhe kapacitete prodhuese. Programi ofron financim deri në 200 milionë lekë, garanci sovraane deri 70%, normë interesi 2–3% dhe afat shlyerjeje deri në 10 vite, me aplikime të hapura pranë bankave partnere dhe online.



23 KORRIK

Konsultim për Profesioneet e Rregulluara:

U zhvillua një tryezë konsultimi me përfaqësues të biznesit mbi Kapitullin 3 të negociatave me BE-në, duke matur nga afër ndikimin ligjor dhe gatishmërinë e tregut për reformat evropiane.



23 KORRIK

Tryezë me Sektorin e Logjistikës:

AIDA organizoi një takim me përfaqësues të sektorit të transportit dhe logjistikës për të diskutuar rritjen e konkurrueshmërisë, kualifikimin e fuqisë punëtore dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale e rrugore.



27 KORRIK

Mbështetje për Bizneset Prodhuese:

Përmes vizitës në pastiçerinë “Luara” u promovuan mundësitë e programit “Dyfisho Sipërmarrjen Tënde” për ofrimin e financimeve me normë interesi preferenciale për bizneset në zgjerim.



29 KORRIK

Marrëveshja me Vietnamin:

U nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për mobilitetin e fuqisë punëtore, i cili mundëson një migracion të rregullt për punësim dhe thellon bashkëpunimin ekonomik mes Shqipërisë dhe Vietnamit.



30 KORRIK

Marrëveshja me Indonezinë:

Gjatë vizitës zyrtare në Xhakartë u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për mobilitetin e punëtorëve, për t'iu përgjigjur nevojave të tregut shqiptar në sektorë si turizmi dhe ndërtimi.



31 KORRIK

Forcimi i Partneritetit me Indonezinë:

U zhvillua një takim me Ministrin e Investimeve të Indonezisë për të hapur rrugën e një bashkëpunimi të ri ekonomik, me synim promovimin e investimeve dhe shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve.